

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 1221 Data. 03.03.2022
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE **ZYRTARE TË TREPÇA SH.A**

Mitrovicë, më 03.03.2022

Në bazë të nenit 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 3 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 20 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 130 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 8 të Statutit të Trepça Sh.A, Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A., në mbledhjen e mbajtur më 03.03.2022, miraton këtë:

Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare të Trepça Sh.A

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e përdorimit të rregullt të automjeteve që janë në pronësi të Trepça Sh.A.

Neni 2

Automjetet (vetura, kombi, cistern, kamion, etj) të Trepça Sh.A janë automjete zyrtare (të regjistruara në emër të Trepça Sh.A) dhe si të tilla janë në pronësi të saj, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllime zyrtare (kryerjes së punëve dhe detyrave të punës) në kuadër të Trepça Sh.A dhe njësive biznesore tjera.

Neni 3

E drejta e përdorimit të automjeteve zyrtare

Jashtë kosoves vetëm me leje të Kryeshefit Ekzekutiv

1. Automjetet zyrtare të Trepça Sh.A për kryerjen e shërbimeve dhe transportit mund të shfrytëzohen për:
 - a. Punët zyrtare në territorin e Kosovës
 - b. Punët zyrtare jashtë territorit të Kosovës
2. Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A i cili ka edhe shoferin personal ka të drejtë të përdor veturën zyrtare 24 orë në ditë, për qëllime zyrtare dhe operative.
3. Përdorimi i automjetit zyrtarë jasht orarit nga udhëheqësit e njësisë biznesore, me qëllim të realizimit efikas të detyrave të punës është i mundur me lejimin nga Kryeshefi Ekzekutiv.
4. Zyrtarët e lartë të shoqëris (Sekretari Korporativ, Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Kryesor i Auditimit të Brendshëm) mund të përdorin automjetet zyrtare të Trepça Sh.A për të kryer punët zyrtare vetëm gjatë orarit të punës.
5. Veturat e terrenit përdoren ekskluzivisht për nevojat e Ndërrmarjes Trepça Sh.A dhe vetëm në bazë të lejes së udhëheqëseve të njësisë, i cili i nënshkruan urdhër udhëtimet për çdo kërkesë për shfrytëzim.
6. Për çdo keqpërdorim të veturës zyrtare nga punëtorët e Ndërrmarjes Trepça Sh.A, përveç keqpërdoruesit, për paarsyeshmërin e dhënies së lejes për shfrytëzim përgjigjet edhe udhëheqësi i njësisë përkatëse.
7. Jashtë territorit të Kosovës automjetet zyrtare mund të përdoren vetëm me leje të Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 4

1. Çdo punëtor i cili ka nevojë që të përdorë automjetin zyrtar, së pari duhet të plotësoj formularin-kërkesën për përdorimin e automjetit zyrtar.
2. Çdo drejtues i automjetit zyrtar është i obliguar që në formularin – fletudhëtimet të shenoj numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, emrat e personave që udhëtojnë dhe numrin e kilometrave në momentin e kthimit si dhe nënshkrimin e përdoruesve.

Neni 5

Drejtuesi i automjetit zyrtar është i obliguar që para pranimit - dorëzimit të automjetit zyrtar të plotësoj formularin e gjendjes së automjetit pasi të ketë kryer kontrollin e automjetit dhe të jetë bindur që ky i fundit është në gjendje të mirë pune, para se ta firmos ai.

Për shkelje të rregullave të komunikacionit me fajin e tij përgjegjësinë e bartë shfrytëzuesi i automjetit zyrtar.

Neni 6

Parkimi i automjetit

1. Pas përfundimit të orarit të punës, të gjithë shfrytëzuesit e automjeteve zyrtare janë të obliguar që veturat t'i kthejnë në vendin e dedikuar për parkimin e veturave dhe çelësi me dokumentacion të iu dorëzohet personave përgjegjës të automjeteve, ndërsa pas orarit të punës këto të u dorëzohen në portë (punëtorëve të sigurimit).
2. Shfrytëzimi i veturës zyrtare pa autorizimin e nënshkruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv do të konsiderohet si jo valid, gjegjësisht do të konsiderohet si keqpërdorim i automjetit. Ndaj shfrytëzuesit të paautorizuar të automjetit do të inicohet procedura disiplinore komform Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve të Trepça Sh.A.

Neni 7

Përgjegjës për servisimin, mirëmbajtje dhe administrimin e automjeteve zyrtare të kompanis është Divizioni i Autoparkut i cili funksionon nën Departamentin për shërbime të përbashkëta.

Neni 8

1. Divizioni i Autoparkut pas pranimit të automjetit plotëson një formular ku evidentohen të dhënat automjetit tipi, nr.i targave, aryseja e dergimit të automjetit në servisim dhe defektet.
2. Divizioni i autoparkut kujdeset që të mbaj me rregull dosjen për të gjitha rastet e servisimeve të automjeteve.

Neni 9

1. Të gjitha kopjet e faturave të furnizimit me karburante, si dhe raporti për përdorimin e automjetit duhet ti dorëzohet shefit të autoparkut brenda 5 ditësh nga dita e përdorimit të automjetit.
2. Divizioni i autoparkut harton raportin për shpenzimet mujore të të gjitha automjeteve zyrtare dhe raporti i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore për përdorimin e automjeteve të Trepça Sh.A, hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe fillon të aplikohet prej ditës së publikimit në webfaqen zyrtare.



Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A

Dr.Sc. Bahri Hyseni